

**FORMË-KËRKESË
PËR
PAJISJE ME LICENCË “SHOQËRI AGJENTI NË SIGURIME”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Rregullores miratuar me Vendim Bordi nr. 79, datë 31.08.2015, “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore unë,

Z/Znj. _____, **përfaqësues ligjor i shoqërisë** _____,

paraqes kërkesën për pajisje me licencë “Shoqëri agjenti në Sigurime”.

1. Veprimtaria e agjentit si person juridik do të kryhet si :

- Shoqëri agjenti Degë e shoqërisë së huaj të agjentit

2. Të dhënat e personin juridik që do të ushtrojë veprimtarinë e agjentit janë:

Emri i shoqërisë sh.a./sh.p.k.

Adresa ku do të ushtrohet veprimtaria / selia:
.....

Nr. kontakti:

Tel, Fax

Faqe interneti.....; Adresë email.....

3. Veprimtaria e agjentit do të ushtrohet në:

A. Klasat e sigurimit të Jo-Jetës

B. Klasat e sigurimit të Jetës

4. Agjenti/të të punësuar të shoqërisë do të jenë:

Emër..... Mbiemër.....Miratuar me Vendim Bordi , nr.....dt.....

Emër..... Mbiemër.....Miratuar me Vendim Bordi , nr.....dt.....

Emër..... Mbiemër.....Miratuar me Vendim Bordi , nr.....dt.....

Nëpërmjet plotësimit të formular kërkesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur këtij formulari, deklaroj se informacioni i paraqitur është i plotë, i vërtetë, i saktë dhe nuk përmban fshehje të fakteve.

Trajtimi i të dhënave personale në këtë formë kërkesë dhe dokumentacionin bashkëngjitur do të bëhet në përputhje me ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi .

Personi Kërkues:

Data _____

(Emër, Mbiemër, Nënshkrim)

Shënim:

- 1. Përzgjedhja e klasave në të cilën do të ushtrohet veprimtaria, do të argumentohet nga plani i biznesit, rregullat e brendshme, si dhe Vendimi i miratimit të agjentëve të punësuar.*
- 2. Kjo formë kërkesë është e pavlefshme nëse nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm.*

DOKUMENTACIONI SHOQËRUES I FORMATIT TË KËRKESËS SË APLIKIMIT PËR LICENCË “SHOQËRI AGJENTI NË SIGURIME”

A. Personi juridik (shoqëri agjenti) që kërkon të pajiset me licencë agjenti në sigurime, duhet të paraqesë:

1. Projekt statutin;
2. Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të shoqërisë;
3. Të dhëna për ortakët/aksionarët, administratorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit të Administrimit dhe personelin, si dhe personat e ngarkuar nga shoqëria për të kryer veprimtarinë e agjentit për shoqërinë
4. Administratori/ët e shoqërisë së agjentëve duhet:
 - i) të kenë diplomë universitare;
 - ii) dokument që vërteton përvojën profesionale të paktën dy vjet në fushën e sigurimeve;
 - iii) deklaratë që gjatë 5 viteve të fundit nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale;
 - iv) deklaratë që nuk kanë qenë dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarrjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
 - v) deklaratë që nuk janë të punësuar në ndonjë shoqëri sigurimi
 - vi) deklaratë që nuk kanë qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ndaj të tretëve,
 - vii) Dokument që vërteton se nuk kanë detyrime fiskale të papaguara në afat, të lëshuar nga administrata tatimore.

Kur personi juridik është shoqëri aksionare, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit të Administrimit të shoqërisë duhet:

 - i) te kene diplome universitare,
 - ii) deklaratë që gjatë 5 viteve të fundit nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale;
 - iii) deklaratë që nuk kanë qenë dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarrjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
 - iv) deklaratë që nuk janë të punësuar në ndonjë shoqëri sigurimi
 - v) deklaratë që nuk kanë qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ndaj të tretëve,
 - vi) dokument që vërteton se nuk kanë detyrime fiskale të papaguara në afat, të lëshuar nga administrata tatimore.

5. Plani i biznesit për tre vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së agjentit, i cili të përfshijë edhe detaje të zhvillimit të tij dhe projektimet financiare;
6. Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politika dhe/ose procedura për:
 - a. mënyrën e informimit të klientëve dhe trajtimit të ankesave;
 - b. mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
 - c. trajtimin e konfliktit të interesit;
 - d. funksionin e përputhshmërisë që siguron përputhjen e aktivitetit të shoqërisë së agjentit me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
7. Adresa në të cilin do të ushtrojë veprimtarinë e agjentit;
8. Dokument që vërteton se shoqëria e agjentëve disponon ambiente dhe infrastrukturë të nevojshme për shitjen e produkteve të sigurimit;
9. Dokumenti bankar që vërteton pagimin e kapitalit minimal në para prej 1,000,000 Lekë, në një nga bankat e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e RSH;
10. Dokument bankar që vërteton se ka garanci financiare të paktën 500,000 Lekë të depozituar në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja që veprojnë në territorin e RSH, në emër të shoqërisë së sigurimit për të cilën vepron.
11. Kontrata e punësimit me kohë të plotë për të paktën një agjent të miratuar;
12. Deklarata për mos qenie palë e lidhur me një shoqëri sigurimi, shoqëri tjetër agjentësh apo shoqëri brokerimi në sigurime dhe risigurime;
13. Dokument që vërteton pagesën e tarifës për depozitim dhe shqyrtim dokumentacioni sipas Rregullores nr. 155, datë 23.12.2014.

B. Dega e shoqërisë së huaj të agjentit që kërkon të pajiset me licencë agjenti në sigurime duhet të paraqesë:

1. Statutin e shoqërisë së huaj, apo aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të vendit të origjinës së shoqërisë së huaj;
2. Dokumentacionin, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në vendin ku ushtron veprimtari si dhe licencën/miratimin për të kryer aktivitet agjenti në sigurime të lëshuar nga autoriteti përgjegjës ;
3. Vendimin e organit drejtues të shoqërisë së huaj për shtrirje të veprimtarisë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe hapjen e degës së shoqërisë së huaj,
4. Dokumentacionin, që vërteton statusin aktual të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda tre muajve të fundit nga data e aplikimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi;
5. Bilancin e shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria ka pasur veprimtari për më shumë se një vit;
6. Miratimin zyrtar për hapjen e degës së shoqërisë së huaj dhënë nga autoriteti përgjegjës i vendit ku ndodhet selia qendrore e saj;

7. Dokumentacionin e përmendur në pikën 2-13 të seksionit A të këtij formulari.
8. Mandat pagesën e tarifës për depozitim dhe shqyrtim dokumentacioni sipas Rregullores së Autoritetit Nr. 155, datë 23.12.2014.

Shënim: Personi juridik, shoqëri e agjentit, degë e shoqërisë së huaj të agjentit, që kërkon të ushtrojë veprimtari agjenti në sigurime, pas marrjes së licencës nga Autoriteti, por para regjistrimit në QKR dhe fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, duhet të disponojë:

- a) sigurimin e përgjegjësive profesionale ndaj palëve të treta, kundrejt dëmeve të shkaktuara nga kryerja e veprimtarisë së agjentit në një shumë jo më të vogël se 100,000 lekë për çdo ngjarje të siguruar, ose jo më të vogël se 150,000 Lekë në vit për të gjitha rastet e sigurimit.